



REPUBLIKA E KOSOVËS

/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/

GJYKATA KOMUNALE NË MITROVICË /OPŠTINSKI SUD U MITROVICI/ MUNICIPAL COURT IN MITROVICA

C.nr. 57/2010

GJYKATA KOMUNALE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshijen juridike te paditesit; Mehmet Mehmeti nga Mitrovica te cilein e perfaqson Avokat; nga Mitrovica, sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditures; Komuna e Mitrovices te cilen e perfaqson Avokati Publik Komunal, baza e kontestit; Vertetim pronesie, vlera e kontestit; 3.240,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.31.01.2012, jep kete;

AKTGJYKIM

I- APROVOHET kerkespadia e paditesit dhe **VERTETOHET** se-Paditesi **Mehmet Mehmeti** nga Mitrovica eshte shfrytzuues i perhershem i palujtshmeris, parc.kat. 2393/3 me kultur, are e klases 2 ne vendin e qujtur 'Tavnik' me siperfaqe **0.06.14** ha sipas qertifikates se pronesise nr. 3300 Zk-Mitrovica e qe evidentohet ne emer te paditures Kuvendi Komunal 1/1.

II- DETYROHET e paditura qe ti njoh kete te drejte paditesit dhe te lejoje qe paditesi kete palujtshmeri ta regjistroje ne emer te tije prane Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne Mitrovicë ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

-Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesi ne padin e parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tije ne seancat e mbajtura ka theksuar se i njejti ne vitin 1964, sipas kontrates gojore me shitesin Rifat Jusufin me qmim prej 3.000.000 din. te athershem ka blere palujtshmerine e cekur ne dispozitiv dhe qe nga momenti i shitblerjes ka hyre ne shfrytzim dhe posedim te kesaje palujtshmerie duke mose qene i penguar nga askush edhe sot e shfrytzoj pa kurfar pengese.

Paditesi ne baze te shitblerjes dhe mbajtjes e ka fituar te drejten e prones per kete patundshmeri, andaje ka interes juridik qe te vertetohet se ai eshte pronar i kesaje ngastre.

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padin dhe kerkespadise ta aprovoi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj

Perfaqsesi i te paditures ne pergjigje te padise dhe kerkespadise e kontestoi kerkespadine dhe kerkoj qe gjykata vendimin ta nxjerr ne baze te rezultatit te provave..

Shpenzimet e perocedures kontestmore nuk i kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te L/PK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Certifikaten mbi pronesin, UI 71208072-02393-0 te dt.10.09.2010 ne emer te paditures, lexoi ekspertzen gjeodete te ekspertit gjeodet; te dt.11.10.2011 si dhe plotsimin e saje nga i njejti ekspert, beri veshtrimin ne kopjen e planit dt.11.10.2011, Procesverbalin mbi vendshiqim te kesaje gjykate, C. nr.57/2010 dt10.10.2011, ndegjoi deshmitaret; dhe si dhe ndegjoi paditesin ne cilesi te pales dhe konstatoi kete gjendje faktike;

Nga Certifikata mbi te drejttat e pronese se palujtshme te cekur me larte konstatohet se parc. kat.2393/3, sipas qertifikates se pronesise 3300 ZK Mitrovice, evidentohen ne emer te paditures..

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me larte konstatohet se; pase matjeve te kryera te parc kontestuese, ka vertetuar se palujtshmerine kontestuese 2393/3 me kultur are kl. 2 me sip. 00.06.14 ha ne vendin e qujtur, Tavnik, evidentohet ne emer te Kuvendi Komunal 1/1, sipas qertifikates se pronesise nr.3300 ZK Mitrovice dhe se shtrirja e rigastres ne fjale ne anen Lidore kufizohet me rrugen, ne ane Veriore me parc. e paditesit, ne anen Jugore me prone private, ndersa ne anen Perendimore kufizohet me pronen private.

Nga kopja e planit shifet shtrirja, perkufizimi dhe siperfaqja e palujtshmeris tani lendore e te cekur ne dispozitiv te aktgjykimit..

Nga proqesverbali mbi vendshiqim i kesaj gjykate te cekur me larte, konstatohet se Gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejt ne vende konstaton- se palujtshmeria kontestuese eshte e perkufizuar fizikisht me mur nga bllokat. Ne hyrje jane te vendosura dyert e metalta qe sherbejne paditesit si hyrje per ne shtepin e tije. Ne ket palujtshmeri gjenden objekte si Garazha, kuzhuna- verore dhe se tani kjo palujtshmeri sherben si oborr per ne shtepin e paditesit dhe se rreth e perqark eshte e rrethekuar me shtepija private.

Deshmitari deklaroi se paditesi nga axha im ne vit e pat blere trollin qe e ka edhe sot me qmim 3 milion dinar te athershem.

I njejt i ka qen prezent kur eshte bere shitblerja sipas marrveshjes gojore dhe se ne tersi eshte paguar qmimi i shitblerjes dhe meniher i eshte lane ne shfrytzim te lire dhe te papengushem nga askush gjermetani. Sa e din kjo palujtshmeri ka qene e evidentuar ne emer te shitesit me heret.

Deshmitari _____, deklaroi- sipas njohurive qe ka kete palujtshmeri tani kontestuese e kane bler paditesi dhe babai i tije nga shitsi _____ me qmim prej 3 milion dinar qysh ne vit. _____. Ne kete truall ka qene e ndertuar shtepia e moqme ku i ka pase edhe disa objekte percjellse-shupa, mirepo tani e ka ndertuar edhe shtepin e re. Nga shitblerja e gjer me tani ket truall e shfrytzoj pa pengesa nga askush.

Paditesi ne cilti te pales deklaroi; me 12 Mars te vit.1964 une dhe babai im nga shitesi Rifat Jusufi kemi bler truallin tani lendor sipas marrveshjes gojore me qmim 3.miljon dinar te athershem. Trualli ka qene i perkufizuar me taraba, ne te ka qene 1 shtepi e gjate si dhe 2 objekte percjellse-shupa. Siperfaqja e trollit ka qen 10 ari e 30 metra. Pase lufte shtepia ekzistuse eshte djegur dhe rrenuar e pastaj une kame ndertuar shtepin e re. Qmimi i shitblerjes eshte paguar ne tersi dhe menjeher ka hy ne shfrytzim te lire ku gjermetani e shfrytzoj pa kurfar pengese..Me rastin e shitblerjes shitesi vet na ka thene se ky truall eshte i tije ka Tapi per te dhe ne qdo kohe kur te jete nevoja une ua perkthej. Bartja nuk eshte bere ne emer te tije per shkake te shpenzimeve te larta. Tani ne kohe te fundit kur ka desht ta marre nje kredi ka kuptu se kjo palujtshmeri evidentohet ne emer te paditures.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se patundshmerin tani lendore e ka blere paditesi _____, me 12.Mars _____ me qmim 3.000.000 dinar, te cilin qmim ne tersi ia ka paguar shitesit _____ i cili menjeher iu ka lene ne disponim dhe shfrytzim te lire kete palujtshmeri- bleresit _____, tani paditesit i cili _____ se bashku me antaret e familjes se tije _____ e ka shfrytzuar kete palujtshmeri pa pengesa qe nga momenti i shitblerjes e gjer me tani.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronetin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr. O3/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderprer nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronetin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes _____, paditesi e ka pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire keto palujtshmeri dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronise ne baze _____ jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i _____ palujtshmerie.

Mbajtja me mirbesim ekziston se paditesi kete palujtshmeri _____ e ka blere nga shitesi _____ i cili i ka premtuar se per ket ka edhe Tapin dhe se do tja barte kur te kete nevoje .Gjithashtu edhe nga konstatimi i ekspertit u vertetua se kjo palujtshmeri eshet e perkufizuar me _____ palujtshmeri ne prone private

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse paditesi e ka blere kete palujtshmeri nga i paditeuri , qysh nga vitet 1964.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes, paditesi ka hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te kesaje palujtshmerie lendore gjer me tani. Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit ne menyre- derivative- me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejttat te tjera sendore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen. 450 dhe 459 te LPK.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA KMUNALE NE MITROVICE

C nr 57/2010 dt. 31.01.2012.

Gjyqtari,
Ragip Kadriu,

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Qarkut ne Mitrovice e permes kesaje gjykate.

Saksin e pershkrimt e verteton;